

**SUPREME COURT OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**  
**KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës**  
**ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-180/14**

**Prishtinë,**  
**27 prill 2016**

Në çështjen juridike të

**L.R.**

Ankaraja 4/4

Prizren

**Pala ankuese**

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredni, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Beshir Islami, Anëtarë, duke vendosur lidhur me Ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/239/2014 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA11600), të datës 30 Prill 2014, pas seancës gjyqësore kryesore të mbajtur më 27 prill 2016, mori këtë

**AKTGJYKIM**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga L.R. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/18239/2014, të datës 30 Prill 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA11600.
  
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/239/2014, i datës 30 Prill 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA11600.

**Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike**

1. Më 2 Shkurt 2007, L.R. (më tutje: Pala ankuese) ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), e regjistruar me numër të lëndës KPA11600, duke kërkuar ri-posedimin e banesës e cila gjendet në kompleksin e banesave të oficerëve numër IV/4 Prizren me sipërfaqe prej 64.44 metryra katrorë (më tej prona e kërkuar), për të cilën ai deklaroi se është pronës e përbashkët e tij dhe e gruas së tij K.R. blerë nga pronari i mëparshëm në vitin 2007.
2. Së bashku me kërkesën ai në AKP dorëzoi:
  - Kopjen e kontratës së shitblerjës Leg.Nr. 640/07 të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren me 31 Janar 2007 me të cilën dëshmohej se bashkëshortet L.R. (Ankuesi) dhe K.R. e kanë blerë pronën nga pronari i mëparshëm S.B.;
  - Kopjen e Aktvendimit nga administrata komunale për caktimin e tatimit në pronë datë 19 Prill 2007;
  - Kopje e kontratës së shitblerjës e lidhur në mesë të autoritetit ushtarak si bartës i së drejtës së ndarjës dhe S.B. si blerës i banesës.

Dokumentet e lartcekura janë verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.

3. Më 06 Shtator 2006, AKP-ja e identifikoi pronën e kërkuar duke nendosur shenjën e njoftimit për kërkesë. Prona u gjet e zbazet dhe askush nuk e kontestoi kërkesën.
4. KKPK-ja me vendimin e vet KPCC/D/C/239/2014 të datës 30 Prill 2014 e hodhi poshtë kërkesën për faktin se kërkesa ishte jashtë mandatit të Komisionit pasi që posedimi i pronë së kërkuar nuk ishte humbur për shkak të konfliktit të armatosur.
5. Vendimi i KKPK-së iu dorëzua Ankuesit më 26 Qershor 2014. Më 25 Korrik 2014, është paraqitur ankesa nga paraqitësi i kërkesës / pala ankuese.

**Pretendimet e palës ankuese**

6. Në ankesë, pala ankuese pretendon se bazuar në dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03-L/79, Gjykata Supreme obligohet që t'i leshoi atij vendimin individual pozitiv pasi që kjo nuk është shprehimisht e ndaluar me Rregullore dhe Ligj. Pala ankuese nuk e mohon se tani ajo është në posedim të papenguar të pronës por kërkon një vendim në favor të tij nga Gjykata.

**Arsyetimi ligjor****Pranueshmëria e ankesës**

7. Ankesa është paraqitur brenda afatit kohor prej 30 ditësh të paraparë me Ligjin nr. 03/L-079 neni 12.1 dhe është e pranueshme.

### **Meritat e ankesës**

8. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë për zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me konfliktin që përfshijnë rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Prandaj, paraqitësi i kërkesës duhet të provoj jo vetëm titullin e pronësisë mbi një pronë të paluajtshme private por edhe të dëshmojë se ai apo ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur.
9. Nga provat e mbledhura para KKPK-së, në veçanti me kontratën e shitblerjes, del se prona e kërkuar i është blerë në Janar të vitit 2007 dhe se tani pala ankuese është në posedim të papenguar të pronës.
10. KKPK-ja ka mandat të kufizuar që merret vetëm me kërkesat pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private posedimi i të cilave është humbur për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
11. Rrjedhimisht, KKPK-ja ka vepruar drejtë kur e ka konsideruar çështjen si të përjashtuar nga juridiksioni i saj. Gjykata Supreme konfirmon se në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03-L/79, KKPK-ja nuk ka juridiksion të vendos mbi kërkesën pasi që humbja e posedimit nuk buron nga rrethanat e lidhur me konfliktin e armatosur.
12. Lidhur me kërkesën e palës ankuese për një vendim pozitiv duke u nisur nga fakti se Rregullorja dhe ligji nuk e ndalojnë, Gjykata gjeti se kërkesa është e paqëndrueshme pasi që përkufizimi i mandatit në kohë është i lidhur me konfliktin e armatosur dhe rrethanat që lidhen me të dhe se periudha kohore të caktuar me ligj.
13. Duke i pasur parasysh të lartcekurat, në përputhje me nenin 13.3 nën c (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e paraqitësit të kërkesës që t'i kërkojë të drejtat e pretenduara para gjykatës kompetente, nëse e konsideron të domosdoshme.

**Këshillë ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Anna Bednarek, Gjyqtar e EULEX-it**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Sandra Gutaytude, Referent i EULEX-it**